

**Raport i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis
për hapjen e puseve BR-1, BR-2 dhe 1R
Fshati Bardhaj, Bashkia Shkodër,**

Qarku Shkodër

Aktiviteti: Hapje e puseve për furnizim me ujë të pijshëm

Porositës:

**Shoqëria Rajonale Ujësjetës
Kanalizime Shkoder Sh.a**

Përgatitur nga:

**Ekspertë të Vlerësimit të Ndikimit
në Mjedis dhe Auditimit Mjedisor
Dr. Ing. Hamdi Beshku
Ing. Shkelqim Dezhgiu**



Tiranë, Shkurt 2024

PËRMBAJTJA

Përmbledhje.....	4
1.1 Qëllimi dhe objektivat e VNM.....	7
1.2 Kërkesa të legjislacionit mjedisor dhe Institucional që lidhet me perprojektin.....	8
1.2.1 Analizë e kuadrit ligjor dhe atij rregullator për vlerësimin e impaktit në mjedis.....	8
1.2.2 Kërkesa të direktivave të Bashkimit European për mbrojtjen e mjedisit (Shkalla e implementimit të legjislacionit ndërkombëtar në atë shqiptar)	9
1.3 Përshkrimi i metodikes së zbatuar për hartimin e raportit.....	10
1.3.1 Metodika e zbatuar dhe mënyra e sigurimit të informacionit.....	11
1.3.1 Konsultimet e realizuara gjatë hartimit të raportit paraprak.....	12
1.3.1 Vështirësitë gjatë hartimit të informacionit.....	12
2 Përshkrimi i projektit.....	11
2.1 Vendndodhja e pusit ekzistues.....	11
2.2 Qëllimi dhe karakteristikat fizike të projektit.....	12
2.3 Teknologjia shfrytëzimit të ujit të pusit të projektuar.....	12
2.4 Lidhja e projektit me projekte të tjera ekzistuese.....	16
2.5 Infrastruktura e nevojëshme.....	17
2.6 Lejet dhe liçencat e nevojeshme.....	17
3 Përshkrimi i mjedisit.....	17
3.1 Përshkrimi i karakteristikave fizike të zonës së projektit.....	17
3.1.1 Shtrirja Gjeografike.....	17
3.1.2 Përshkrimi i faktorëve klimatike.....	18
3.2 Ekosistemet, habitatet dhe peisazhi ekzistues.....	18
3.3 Popullsia, hidrologjia dhe infrastruktura ekzistuese.....	19
3.4 Tokat, kategoria e tokës dhe gjeologjia.....	19
3.5 Trashëgimia arkeologjike dhe historike.....	21
3.6 Peisazhi dhe topografia.....	21
3.7 Tiparet e tjera mjedisore.....	21
4 Komponentët mjedisore dhe analiza e tyre.....	21
5. Ndikimet e mundshme në mjedis dhe marrja e masave zbutëse.....	22
5.0 Metodat e zbatuara për parashikimin e ndikimeve negative në mjedis.....	22
5.1 Ndotja e ajrit	22
5.2 Ndotja e ujërave.....	23
5.3 Ndotja e tokës.....	23
5.4 Biodiversiteti.....	24
5.5 Zhurmat.....	24
5.6 Pluhurat.....	24
5.7 Mbetjet urbane dhe inerte.....	24
5.8 Tjetërsim i habitatit.....	25

5.9	Prani të zjarrit.....	25
5.10	Ndikimet në mjedisin ndërkufitarë të projektit.....	25
5.11	Plani i emergjencave.....	25
5.12	Trajnimi i Personelit.....	25
6	Plani i menaxhimit dhe monitorimit të mjedisit.....	25
6.1	Plani i menaxhimit.....	25
6.2	Plani i monitorimit.....	26
6.2.1	Masat për rigjenerimin e mjedisit.....	27
6.2.2	Elementët dhe programi i monitorimit.....	27

LISTA E TABELAVE

Tabela 1	Të dhëna për puset e projektuara.....
Tabela 2	Prerja e litologjike e pritshme e pus- shpimeve BR-1, BR-2 dhe 1-R.....
Tabela 3	Karakteristikat e lëngut larës.....
Tabela 4	Të dhëna për thellësinë dhe konstruksionin e pusit të projektuar.....

LISTA E FIGURAVE

Figurë 1	Projekt-skema e hapjes dhe nxjerrjes së ujit nga puset.....
Figurë 2	Pamje e vendosjes së pus-shpimeve të projektuar.....
Figurë 3	Projekt-prerjet litologjike të pritëshme dhe konstruksionet e puseve Bardhaj..

ANEKSE

Aneks 1	Nivelet e lejuara të zhurmës në mjedise të caktuara.....	29
---------	--	----

PERMBLEDHJE

Raporti paraprak i vlerësimit të ndikimit në mjedis hartohet për hapjen e puseve hidrogeologjik BR-1, BR-2 dhe 1R në fshatin Bardhaj. Hapja e puseve ka qëllim që të përdoren për furnizim me ujë të pijshëm banorërt e fshatrave Bardhaj dhe Bleran në Njësisë Administrative Rrethina në bashkinë Shkodër. Ky raport ka për qëllim vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen në mjedis nga zhvillimi këtij projekti, pra nga hapja e këtyre puseve.

Për këtë aktivitet zhvilluesi do të përmbushë të gjitha kërkesat e vendosura nga institucionet përkatëse si dhe paisjen me lejet e nevojshme.

Shpimet që do të hapen, për të cilët është hartuar ky raport vlerësimi paraprak i ndikimit në mjedis, gjendet në fushën e Bardhajve, bashkinë Shkodër. Ato gjithashtu gjenden në afërsi të bregut të majtë të lumit Kiri. Janë projektuar për tu hapur 3 puse, dy prej tyre do të jenë në shfrytëzim të vazhdueshëm, dhe njëri prej tyre (1R) do të jetë rezervë në rast avarie apo rimonti të ndonjërit nga 2 të tjerët. Sasia e ujit që mendohet të shfrytëzohet nga të dy pusët do të jetë 8-10 l/s., të dhëna që përfshihen në këtë raport.

Në raport gjithashtu përcakton detyrat dhe mjetet e nevojshme për arritjen e misionit dhe objektivave në jetën e komunitetit, si dhe për të integruar mbrojtjen ambientale në jetën e përditshme, sidomos ato që i përkasin fazës së hapjes së pusit dhe që kanë të bëjnë me mënyrën e furnizimit dhe shkarkimit të ujit të përdorur gjatë hapjes së tij.

Gjithashtu, në të synohet që të përcaktohet e rekomandohen masat teknike- organizative për zbutjen negative që mund të krijohen gjatë zhvillimit të këtij projekti.

Në zbatimin e projektit zhvilluesi do të marrë të gjitha masat për zbatimin me përpikmëri të projektit të hartuar me qëllim që ai të sigurojë një zhvillim normal të tij pa dëmtuar mjedisin.

Investimi që do të kryhet, në kuadër të zbatimit të projektit, do të ketë impakt pozitiv në punësim dhe për vetë zhvilluesin.

Për shfrytëzimin e ujit të këtij pusi, për qëllimet e përdorimit të furnizimit me ujë të pijshëm, sipas plan biznesit nuk parashikohen punime ndërtimore të tilla si hapja e pusit, e kanaleve dhe tubacione që kalojnë nga pompa zhytëse në rezervarët e prej andej në në repartin e shkrirjes të uzinës, pasi të gjitha këto janë kryer me kohë më parë.

Skema e nxjerrjes së ujit nga pusi i projektuar e cila është paraqitur në figurën 1. Në këtë skemë jepen të dhëna të pritshme për pusin e projektuar, si niveli statik e dinamik, vendosjen e elektropomës e disa të dhëna rreth saj dhe tubin e dërgimit të ujit nga elektropompa në sipërfaqe.




Fig. 1: Projekt-skema e hapjes dhe nxjerrjes së ujit nga pusët.

Mbas daljes në sipërfaqe të ujit, qëllimi është të furnizohet me ujë të pijshëm depon 75 m³ ku do të behet mbledhja e ujit të të gjitha puseve. Nga pusi, uji kalon nëpërmjet tubave plastike me diametër 110 mm të montuara dhe të futura në kanale deri në dhomën e trajtimit të ujit.

Nga depo 75m³ uji dërgohet me ngritje mekanike duke përdorur set pompash, perkatesisht ne depo 150m³ ne Bleran dhe ne depo 150m³ ne Bardhaj.




Fig. 2: Skema e furnizimit me ujë të pijshëm..

Uji pas përdorimit, trajtohet nga gropa septike vetjake (personale) te vete banoreve te zones

1.1 QELLIMI DHE OBJEKTIVAT E VNM-së

Qëllimi i VNM-se është të vlerësojë ndikimet negative dhe pozitive të projektit si dhe të paraqesë masat që duhet të aplikojë subjekti për reduktimin apo shmangien e ndikimeve negative në mjedis dhe komunitet.

Objektivat e VNM-së

Objektivi kryesor i raportit të VNM-së është që të përmbush kërkesat e legjislacionit shqiptar, me qëllim që të kemi një zhvillim të qëndrueshëm mjedisor.

Objektivat specifike të VNM-së janë:

- Të identifikojë dhe vlerësojë ndikimet e rëndësishme mjedisore nga hapja dhe shfrytëzimi i pusit.

- Për të përcaktuar përputhshmërinë e përdorimit të pusit dhe të vlerësojë kushtet lokale mjedisore.
- Për të parë avantazhet nga shfrytëzimi i ujërave nëntokësor nëpërmjet shpimeve të puseve.
- Për të vlerësuar dhe zgjedhur alternativën më të mirë nga opsionet e mara në studim.
- Të përfshijë planet e menaxhimit mjedisore dhe mekanizmat monitoruese gjatë fazave të shfrytëzimit të ujërave nëntokësor nëpërmjet puseve.

Objektivat e projektit

- Shfrytëzimi i ujit të pusit do të kryhet për përdorim për ujë të pijshëm nga banoret e fshatrave Bardhaj dhe Bleran.
- Plotësimi i kushteve teknike dhe higjeno-sanitare të shfrytëzimit të ujit.
- Shfrytëzimi i ujërave nëntokësore në kushte të përshtatëshme dhe në harmoni me mjedisin duke ju përmbajtur parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Termet e referencës

Termet e referencës të cilat janë aplikuar për hartimin e raportit të VNM-se, janë:

- Takime dhe qëndrimi në kontakt të vazhduar me subjektin që ka në përdorim këtë pus me objektiv shfrytëzimin e sasisë së ujit deri në 7.5 m³/d, me qëllim përdorimin e tij si ujë i pijshëm, për të përcaktuar kërkesat dhe përgjegjësitë sipas detyrimeve ligjore si dhe afatet kohore për hartimin e raportit të plotë të VNM-së.
- Hartimi i raportit të VNM-se i cili ndër të tjera përmban, ndikimet negative dhe pozitive në mjedis nga përdorimi i pusit të shpimit, si dhe rekomandimin e masave për të parandaluar dhe minimizuar ndikimet negative.
- Përcaktimin e tipareve të mjedisit ekzistues në zonën ku do të shfrytëzohet pus-shpimi për ujin teknologjik dhe sanitar e rreth tij.

1.2. Kërkesa të legjislacionit mjedisor dhe Institucional që lidhet me përojektin

1.2.1 Analizë e kuadrit ligjor dhe atij rregullator për vlerësimin e impaktit në mjedis

Veprimtaria për shpim për furnizim me ujë, siç është parashikuar në projekt, përfshin veprimtarinë për kryerjen e shpimit, që fillon me përgatitjen e vendit ku do të hapet pusi, procesi teknologjik i hapjes së tij e deri në kthimin e terenit në gjendjen ekzistuese.

Për këtë qëllim në legjislacionin shqiptar ka një kuadër ligjor të plotë të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe që është përafëruar plotësisht me direktivat e BE-së për mjedisin, i cili parashikon kërkesat kryesore që lidhen me mbrotjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të komponentëve përbërës të mjedisit. Ndër to mund të përmendim:

LIGJI Nr.10 431, datë 9.6.2011. “PËR MBROJTJEN E MJEDISIT”, i cili ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe

pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

LIGJI Nr.10 448, datë 14.7.2011“PËR LEJET E MJEDISIT”, është një ligj që parashikon gjithashtu një sërë kërkesash për pajisjen e aktiviteteve me leje mjedisi. Ne lejen e mjedisit integrohen një sërë kushtesh për mbrotjen e tij dhe për këtë qëllim raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis duhet të marrë në konsideratë :

- a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë;
- b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.

LIGJI Nr.10 440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis’, parashikon kërkesat e përgjithshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti lidhen me:

- Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.
- Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.
- Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.
- Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Ligji Nr. 10463, Dt. 22. 09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, parashikon masa dhe kërkesa specifike pikerisht në nenin 6 të tij që lidhet me:

- a. parandalimi i mbetjeve;
- b. përgatitja për ripërdorim;
- c. riciklimi;
- d. rikuperime të tjera; dhe
- e. asgjësimi.

VKM nr. 912, datë 11.11.2015 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis”

VKM Nr.249, date 24.04.2010 "Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementeve të lejes mjedisore"

VKM Nr.268, date 24.04.2010 "Për certifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe të auditimit mjedisor."

VKM Nr.805, date 4.12.2010 "Për miratimin e listës së veprimtarive që ndikojnë në mjedis, për të cilat kërkohet Leje Mjedisore.

VKM Nr.24, date 22.01.2004 "Për veprimtarinë e inspektoriatit të mjedisit"

VKM Nr.177, date 31.03.2010 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret.

1.2.2 Kërkesa të direktivave të Bashkimit European për mbrojtjen e mjedisit (Shkalla e implementimit të legjislacionit ndërkombëtar në atë shqiptar)

Kërkesat e legjislacionit ndërkombëtar janë të integruara në dokumentat e konventave, protokolleve dhe direktivave të vecanta të Bashkimit European. Këto direktiva dhe kërkesa të legjislacionit european për mjedisin janë implementuar në legjislacionin shqiptar mjedisor.

Pjesë e rëndësishme e këtij legjislacioni mund të konsiderohen ligjet e miratuara në vitet 2011, Për Ratifikimin e "**Protokollit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM)**".

1.3 Përshkrimi i metodikes së zbatuar për hartimin e raportit

Për hartimin e raportit të VNM-se ka qene e nevojeshme zbatimi i një sërë hapash me qëllim marjen e informacionit të duhur për projektin, njohja me tiparet ekzistuese mjedisore të zonës në mënyrë që të kemi një vlerësim gjithëpërfshirës të impakteve negative dhe pozitive që priten nga instalimi dhe funksionimi i projektit.

Disa nga hapat kryesore të metodikes së zbatuar për hartimin e raportit janë:

- Njohja me projektin dhe marja e të gjithë informacionit të nevojshëm mbi projektin nëpërmjet takimeve dhe komunikimit elektronik me shoqërinë.
- Konsultimi me legjislacionin shqiptar për mjedisin me qëllim që raporti të jetë në përputhje të plotë me kërkesat e ligjore.
- Vajtja ne terren për tu njohur me kushtet e mjedisit ekzistues dhe tiparet fizike të tij.
- Paraqitja e ndikimeve si dhe propozimin e masave lehtësuese për të minimizuar ndikimet negative.
- Rishikimin e raportit e me pas dorëzimin e tij.

1.3 Metodika e zbatuar dhe mënyra e sigurimit të informacionit

1.3.1 Autorët e hartimit të raportit

Hartimi i këtij raporti u realizua nga ekspertët Ramazan Myrto i Çertifikuar me vendimin nr.13, nr. 116 Regj, datë 23.11.2004, shëshuar nga Ministri i Mjedisit; person fizik me Nipt K31424142N me seli në Tiranë me adresë Tiranë, Tiranë, Rruga "Reshit Collaku", P23/1/30 dhe Hamdi Beshku, ekspert mjedisor, inxhinier hidrogeolog.

Eksperti Ramazan Myrto ka një eksperiencë të gjatë dhe punon si subjekt privat, Person Fizik që nga viti 1996. Autorët e këtij raporti janë të certifikuar si Ekspertë të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Auditimit Mjedisor dhe kanë aktivitet të gjerë të zhvilluar për raporte e studime mjedisore.

Subjekti privat përveç veprimtarisë në fushën e mjedisit kryen edhe mjaft studime të tjera në fushën e gjeoshkencave që lidhen kryesisht me gjeologo inxhinierike, hidrologjike, hidrogeologjike e në fushën minerare.

Autoret të cilët kanë punuar për hartimin e raportit

Ing. Ramazan Myrto

Dr. Ing. Hamdi Beshku

Ing. Elisabeta Poçi

1.3.2 Metodika e zbatuar dhe mënyra e sigurimit të informacionit

Para së të nise hartimi i raportit të VNM është e domosdoshme njohja me teknologjinë e hapjes së pus-shpimit, me qëllim marrjen e masave të nevojshme nga shpuesi profesionist dhe zhvilluesi. Këto informacione janë marrë mjaft qartë nga shoqëria zhvilluese e cila ka qënë bashkëpunues dhe mjaft të interesuar për gjithçka që do të paraqitet në këtë dokument. Grupi hartues i VNM-se ka organizuar takime me përfaqësues të shoqërisë për të marrë informacionin e nevojshëm.

Krahas takimeve ka pasur komunikime të vazhduara me postë elektronike për çdo pyetje apo paqartësi.

1.3.3 Konsultimet e realizuara gjatë hartimit të raportit paraprak

Janë realizuar konsultime mes punonjëse te aktivitetit që do të kryejnë hapjen e pus-shpimit e zhvilluesit të projektit për hapjen e pusit e përdorimin e tij, në zbatim të ligjislacionit shqiptar.

1.3.4 Vështirësitë gjatë hartimit të informacionit

Gjatë hartimit të pjesës teknike të informacionit nuk janë hasur vështirësi pasi shoqëria ka projekt konkret të hapjes së pusit. Vështirësi janë hasur në mbledhjen e të dhënave ekonomike dhe sociale të zonës pasi në vendin tonë akoma nuk ka një regjistër të saktë të dhënash.

2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

2.1 Vendndodhja e pus-shpimeve

Vendndodhja e 2 pus shpime të projektuar të radhës së parë (pusi nr.1, BR-1 dhe pusi nr.2, BR-2) dhe pus-shpimit nr. 1R (pus reserve) është dhënë në figurën 2.

Koordinatat në sistemi KRRGJSH dhe Albanian 1987/GK Zone 5 të puseve që do të hapen janë dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 1: Të dhëna për pusët e projektuara

Emërtimi i pusit	KRRGJSH		Albanian 1987/GK Zone 5		Z	Th, projek, m	pruja e pritshme, l/s
	E	N	E	N			
Pusi kërkimor nr.1, BR-1 (i radhës së parë)	461994.4	4661955.2	4379392.7	4663016.1		50	4-5
Pusi kërkimor nr.2, BR-2 (i radhës së parë)	461974.8	4661400.8	4379366.6	4662461.9		50	4-5
Pusi 1R (rezerve)	462264.6	4662173.6	4379665.5	4663231.4		50	4-5



Figura 2 Pamje e vendosjes së pus-shpimeve të projektuara

2.2 Qëlimi dhe karakteristikat fizike të projektit

Fshatrat Bardha dhe Bleram kanë nevojë për furnizim me ujë të pijshëm. Për këtë qëllim shoqëria kërkon të hapë pusët për të shfrytëzuar burimet ujore nëntokësore brenda normave të lejuara duke shmangur furnizimin me ujë nga largësi të mëdha.

Një synim tjetër është të përcaktojë e rekomandojë masat teknike organizative për zbutjen e ndikimeve negative që mund të krijohen gjatë zhvillimit të aktivitetit.

Për të realizuar respektimin e mjedisit dhe për të ulur ndikimin e impaktit në mjedis, subjekti ka bërë një punë të kujdesshme kërkimore, në mënyrë që të mos shkaktojë probleme tek banorët

dhe mjedisi perreth. Gjithashtu projekti përmban metoda dhe pajisje bashkohore për hapjen dhe shfrytëzimin ujqor të këtij pusi.

Ky projekt pritet të ketë mjaft aspekte pozitive në drejtim të:

- Hapja dhe shfrytëzimi i këtyre puseve bën të mundur furnizimin me ujë të pijshëm të rreth 5,000 banorëve të cilët aktualisht nuk kanë akses në furnizim me ujë të pijshëm.
- Shfrytëzimi i ujqit brenda normave të lejuara dhe matja e sasisë së shfrytëzimit nëpërmjet matësave të ujqit.
- Mbrojtja e burimeve ujqore nëntokësore duke respektuar kushtet teknike të shfrytëzimit.

2.3 Teknologjia e hapjes dhe shfrytëzimit të ujqit të pusit

Metoda e shpimit të pusit

Për hapjen e këtyre shpimeve janë përcaktuar metoda e shpimit me rotullim ose kokë rrotulluese (top drive) dhe përdorim të solucionit të argjilës bentonite si lëng larës gjatë kryerjes së shpimit.

Për realizimin e shpimit do të përgatitet vendi i punës për mundësinë e fillimit të procesit të shpimit, ku do të vendoset autosonda me keto të dhëna:

- Kapaciteti ngritës i sondës deri 20 ton
- Instrumenti i shpimit (tubot e shpimit) $\Phi=4\frac{1}{2}$ "
- Numri i rrotullimeve të tubove të shpimit $N = 60-90$ rrot/min
- Prurjet e pompës $Q = 0.15$ l/sek

Prerja litologjike

Puset parashikohen të kenë këtë prerje litologjike:

Tabela 2 Prerja e litologjike e pritshme e pus- shpimeve BR-1, BR-2 dhe 1-R

Intervali (m)		Trashësia (m)	Litologjia
Prej	Deri		
0.0	3.0	3.0	Suargjila
3.0	7.0	4.0	Rëra e zhavorr jo ujëmbajtës
7.0	14.0	7.0	Argjila me përzierje rëre
14.0	47.0	33	Zhavore-zhure dhe rëra
47.0	50.0	3.0	Argjilite dhe ranor

Thellësia e pusit dhe diametri e shpimit

Puset do të hapen deri në thellësinë 50.0m. Pusi nga sipërfaqja e tokës deri në thellësinë përfundimtare 10.0m, do të shpohet me diametër 400mm, nga 20m deri në fund (50m) do të

shpohet me diametër 350mm. Armatosja e tij do bëhet me tuba dhe filtra çelikut të galvanizuar me diametër 250 mm.

c.2 Zhvillimi i pusit

Pusi kanë ndjekur rrugën tradicionale për zhvillimin e tij:

- Pastrim i trungut të pusit;
- Mbushje me granil për secilin pus e hapësirës unazore ndërmjet diametrit të shpimit dhe diametrit të tubave dhe filtrave nga 1.0 deri në 50.0 m thellësi me rërë kuarcore me diametër të kokrrizave 8-10 mm dhe të rumbullakosura mirë dhe me përbërje shumë homogjene;
- Çimentimi i pjesës së sipërme të kolonës së tubave për të mbrojtur ujërat nëntokësore të pusit nga infiltrimet e mundshme të ndotjeve sipërfaqësore nëpërmjet izolimit nga jashtë të pjesës së sipërme të tubave të shfrytëzimit.

Pompimi prove

Pompimi do të kryhet me pompë me prurje rreth 2 l/s, duke futur tubo ujë ngritëse në varësi të dhënave paraprake dhe konstruksionit të pusit. Pompimi do të vazhdojë 72 orë duke bërë matjet intensive të debitit dhe nivelit dinamik, deri në stabilizimin e tyre.

Regjimi i shpimit

Në teknologjinë e shpimit të pusit një vend të rëndësishëm zë dhe regjimi i shpimit të pusit.

Me rregjim të shpimit të pusit kuptojmë kombinimin e drejtë të parametrave të tillë si:

- Peshë mbi daltë
- Numri i rrotullimeve
- Kompletimi i instrumentit të shpimit
- Debiti i lëngut larës
- Tipi dhe diametri i daltës

Këto parametra të regjimit varen nga tipi i sondës dhe fuqia motorike e saj. Zgjedhja e drejtë e parametrave të regjimit të shpimit të pusit bën të mundur shpimin e pusit me ritme të shpejta dhe pa avari.

- Peshë mbi daltë $P_d = 3-4$ ton
- Numri i rrotullimeve të tubave të shpimit $N = 60-90$ rrot/sek
- Debiti i pompës gjatë testit të pompimit $Q = 2$ /sek

Zgjidhja e drejtë e këtyre parametrave varet kryesisht nga fuqia e instaluar në Sondën që realizoi shpimin.

Lëngu larës i shpimit

Shpimi i puseve kërkon një teknologji të përparuar, gjë që lidhet drejtpërdrejtë me larjen e pusit dhe ndërlikimet që ndodhin në shpim.

Zgjedhja e drejtë e lëngut larës dhe parametrave të tij bëjnë të mundur shpimin me sukses dhe me cilësi në akuiferin e projektuar. Për shpimin e pusit do të përdoret lëng i përgatitur me argjila bentonite dhe pak gëlqere.

Për përgatitjen e lëngut larës në pus, si fillim duhet të hapet një grope 6 m³ në krah të pompës që ndodhet në autosonden e shpimit. Para fillimit të shpimit do të përgatiten rreth 4-5 m³ lëng larës.

Për këtë në pus janë siguruar:

- Betonit 6 ton
- Gëlqere 600 kg
- Ujë 30 m³

Solucioni i argjilës përgatitet në gropën e hapur, duke bërë përzierjen e argjilës bentonite, ujit dhe gëlqeres me anë të pompës së argjilës që ndodhet në autosondë. Theksojmë se për përgatitjen e lëngut larës, është përdorur patjetër argjile bentonite, pasi ka avantazhe shumë të larta në krahasim me argjilat e zakonshme.

Sasia e bentonitit në lëngun larës ka qënë në masen 4%, ndërsa parametrat e tjerë të tij të jenë:

Tabela 3: Karakteristikat e lëngut larës

Karakteristika	Simboli	Sasia dhe njësia matëse
Pesha specifike e lëngut larës	γ	1.10-1.15 gr/cm ³
Viskoziteti	ν	50 – 60 sek
Filtrimi i lëngut larës	F	8 – 10 cm ³ /30sek

Konstruksioni i pusit

Konstruksioni i puseve është përzgjedhur në bazë prurjes së projektuar të ij, përdorimit për ujë të pijshëm, qëndrueshmërisë për një periudhë të gjatë shfrytëzimi.

Puset e projektuar kërkimor BR-1, BR-2 dhe 1R (rezervë) do të kenë këtë vendosje të projektuar të tubova dhe filtrave sipas thellësive

Tab. 4: Të dhëna për thellësinë dhe konstruksionin e pusit të projektuar

Intervali, m	Lloji i tubave	Diametri, mm	Gjatësia, m	Trashësia, mm
50 ÷ 44	tub çeliku të galvanizuar pa filtër	250	6	4
44 ÷ 14	tub çeliku të galvanizuar me filtër	250	30	4
14 ÷ 0	tub çeliku të galvanizuar pa filtër	250	14	4

Hedhja e granilit dhe çimentim i grykes së pusit

Për të patur një proces normal të uljes së tubove, u bë që në tubin e parë u përgatit me majë konike ose të vendoset një bashmak në formë konike. Pas procesit të uljes së tubove në pus, behet hedhja e granilit në hapësirë unozore ndërmjet trungut të pusit dhe tubave të rrethimit, nga thellësia 0.5 - 6 m, pra 0.5 m poshtë grykës së pusit ku do të hidhen rreth 2.5m³ granil.

Sasia e granilit u be në bazë të llogaritjeve në pus dhe granili i përdorur është i përmasave 8-10 mm, i marrë pikat te shitjes së inerteve.

Zëvendësimi i lëngut larës me ujë teknik

Pas procesit të uljes së tubove dhe granilimit të pusit, një proces shumë i rëndësishëm është edhe përvetësimi i pusit, me anën e të cilit realizohet dhe detyra e pusit për aktivizimin e tij deri sa të pompohet ujë i pastër. Sasia e ujit që është pompuar në pus ka qenë 4-5 volume pusi, pra 30-35 m³ ujë i pastër. Gjatë pompimit të ujit të pastër një pjesë e mire e argjilës ngeli në pus. Për kushtet në të cilat ndodhet pusi kjo gjë është e pranueshme.

Treguesit teknik të pastrimit te pusit janë sasia e rërës dhe papastërtitë që dalin nga pusi, kështu pusi konsiderohet me uje të pastër që tregon se përvetësimi është bere në rregull.




Figura 3 Projekt-prerjet litologjike të pritëshme dhe konstruksionet e puseve Bardhaj

2.4 Lidhja e projektit me projekte të tjera ekzistuese

Zona ku do të hapen pus-shpimet në fshatin Bardhaj, do të plotësohet me gjithë infrastrukturën e nevojshme për nxjerrje të ujit nga pusit, hartimin e projektit të ujësjellësit deri në furnizimin me ujë të pijshëm nga komuniteti

2.5 Infrastruktura e nevojshme

Lidhja me rrjetin elektrik

Gjatë hapjes së puseve nuk është e nevojshme lidhja me rrjetin elektrik pasi sonda është e pajisur me motorrin e vet të prodhimit të energjisë që i duhet për vënien në punë të instrumentit shpues. Ajo gjithashtu do të jetë e paisur edhe me motogenerator për furnizimin me energji të pompës zhytëse që do të duhet për kryerjen e testit të pompimit dhe marrjes së mostrave për analizë kimike.

Në rastin e vënies në punë të puseve për furnizim me ujë të komunitetit, furnizimi me energji elektrike do bëhet nga rrjeti publik i shpërndarjes sipas kontratës së ujësjellsit me OSSH për nevojat e objektit..

Furnizimin me ujë

Plotësimi i nevojave të furnizimit me ujë, gjatë hapjes së pusit do bëhet me depozita, ku uji do të jetë i pastër dhe do të blihet. Pas vënies në punë të puseve, uji i tyre do të furnizojë me ujë të pijshëm fshatrat Bardhaj dhe Bleran.

2.6 Lejet dhe liçencat e nevojshme

Sipas ligjit nr. 10 440 datë 7.7.2011 hapja e shpimit për furnizim me ujë, i nënshtrohet procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Metologjia e vlerësimit të ndikimit në mjedis është përcaktuar në *VKM nr. 912, datë 11.11.2015* “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis”.

3.PERSHKRIMI I MJEDISIT

3.1 Përshkrimi i karakteristikave fizike të zonës së projektit

3.1.1 Shtrirja Gjeografike

Zona e studimit ku do të zhvillohet projekti është në fshatrat Bardhaj dhe Bleran, pjesë e Njësisë Administrative Rrethinat, në bashkinë Shkodër. Pozita gjeografike e fshatit paraqitet shumë e favorshme. Ajo shtrihet në afërsi të qytetit Shkodër, jo më larg se 3-4 km nga qendra e tij. Zona bën pjesë në planshetat K-34-64-C-c (ana jugore e zonës së studimit) dhe K-34-64-C-a (ana veriore e zonës së studimit).

Në pikpamje gjeomorfologjike rajoni paraqitet fushoro-kodrinor. Ai përfshin pjesën verilindore të ultësirës së Shkodrës, e cila ndodhet në fushën ndërmjet lumenjve Kiri – Rrjoll. Kjo zonë përfshin territorin ku janë vendosur fshatrat Shtoj i vjetër në veri të saj, dhe Bardhaj e Bleran më në jug.

Rajoni i studimit parqet një sektor me origjinë tektonike që i është nënshtuar veprimtarisë gërryese dhe akumuluese të lumenjve që e përshkojnë atë (Kiri, Vraka dhe Rjoll).

Zona fushore ku është vendosur fshati Bardhaj është në bregun lindor të lumit Kir, në rrjedhën e poshtme të tij, deri te ura e rrugës automobilistike Shkodër-Njedë (në afërsi të bashkimit të tij me lumin Drin). Fusha ka drejtim me zgjatje sipas rrjedhjes së lumit Kir, me një gjatësi prej rreth 4.0 km dhe gjerësi që varion nga disa qindar metra deri në 2.0 km. Kjo fushë është e vendosur midis kuotave 15 dhe 35 metra mbi nivelin e detit.

Pjerrësia e fushës shkon duke u ulur nga veriu në jug me vlerat rreth 7 deri në 12 për mijë, ndërsa nga lindja në perëndim me pjerrësi 1-2 për mijë.

Në anën lindore të fshatrave të përmendur ngrihet zona kodrinore me lartësitë më të mëdha deri në +120 metra.

3.1.2 Përshkrimi i faktorëve klimatike

Kushtet klimaterike, të rajonit të studiuar janë të tilla që e klasifikojnë atë në zonën mesdhetare fushore bregdetare, që dallohet për bollshmëri reshjesh atmosferike. Sasia më e madhe e tyre bie gjatë dimrit dhe vjeshtës. Çdo vit bie mesatarisht 1595 mm reshje por nuk janë të veçanta rastet kur sasia e reshjeve të matura i kalon 1770 mm. Shpesh reshjet janë të rrëmbyeshme. Numri i ditëve me reshje gjatë vitit lëkundet midis 107-115 ditëve. Shtresa e dëborës nuk është karakteristikë e përvitëshme. Trashësia e saj në raste të zakonshme arrin 8-20 cm ndërsa në raste të rralla trashësia e saj arrin deri 40-45 cm.

Temperaturat mesatare të ajrit luhaten nga 15°- 16° C, ndërsa ajo e muajit Janar zbritet në 4°-5° C. Temperatura minimale zakonisht lëkundet nga - 3° C deri në - 7.5° C. Temperatura mesatare në muajin gusht i kalon 25° ndërsa temperatura minimale absolute arrin - 7.5° C (në muajin Janar).

3.2 Ekosistemet, habitatet dhe peisazhi ekzistues

Fauna dhe flora

Zona e studimit bën pjesë në bashkinë Shkodër e cila është shumë e pasur në florën dhe faunën, edhe pse në dekadat e fundit është dëmtuar në saj të gjuetisë informale dhe ka një numur të konsiderueshëm të specieve të rrezikuara që po shkojnë drejt zhdukjes. Rajoni ka një gamë të gjerë flore dhe faune. Ekzistojnë specie bimësh në përqindje të lartë në raport me sipërfaqen e rajonit. Flora e zonës është e pasur me pyje bredhi, ahu, pisha, si dhe pemë frutore, bimë dekorative.

Zona e studimit shtrihet kryesisht në zonën vertikale bimore, në zonën e makje që shtrihet deri në lartësi 400-500 m lartësi mbi nivelin e detit. Prej drurëve dhe shkurreve gjethëmbajtëse, më të përhapura të kësaj zone, janë: ilqja, dëllinja e kuqe, shqopa, ulliri, mareja, dafina etj. Prej drurëve dhe shkurreve gjetherënëse mund të veçojmë: qelbësi, shega, shkoza e zezë, murrizi një bërthamësh, manaferra, driza, krekëza, thanukla, vidhi i bardhë, amorfa shkurre, gjineshtra, frashër uji, frashëri i bardhë, plepi i bardhë, plepi i zi, shelgu i zi, shelgu i kuq, vërrri i zi, fiku etj.

3.3 Popullsia, hidrologjia dhe infrastruktura ekzistuese

Popullsia

Bashkia e Shkodrës dhe njësia administrative rrethina janë njaft të populluarat. Vetë zona në fshatrat Bardhaj është një zonë e krijuar pas ndryshimeve demografike dhe popullohet nga rreth 5000 banorë. Ajo është gjithashtu shumë afër qytetit të Shkodrës prandaj nevojat për ujë të pijshëm janë të mëdha.

Hidrologjia e rajonit

Në pikëpamje hidrografike, lumi Kir, gjatë periudhës Kuaternare, ka luajtur një rol të rëndësishëm në formimin e relievit që zona ka sot. Ai gjithashtu edhe sot, luan një rol të madh në ushqimin e akuiferit. Kiri është degë e lumit Drin me gjatësi nga burimi deri në derdhje rreth 30 km. Ky lum rrjedh nga shkëmbinjtë karbonatike të Alpeve në zonën e Dukagjinit. Gjatë gjithë rrjedhjes së tij, lumi i Kirit formon lugina të ngushta me formen e gërmes «V», veçanërisht në zonën e Prekalit.

Në ultësirën e Shkodrës lumi Kir hyn në afërsi të Urës së Mesit, duke kaluar në skajin verilindor të saj dhe në krahun e djathtë të fushës së Shtoit të Vjetër, duke derdhur ujërat e tij në lumin Drin në juglindje të qytetit të Shkodrës.

Niveli regjisor i prurjeve të lumit Kir është direkt në funksion të sasise së reshjeve atmosferike. Në stinen me lagështire vjeshte-dimer-pranvere, shtrati i Kirit është gjithmonë me ujë, duke patur rrjedhje intensive, kurse gjatë periudhës së thatë të verës (korrik-gusht-shtator) në këtë zonë lumi Kir ka tharje të përkohshme për shkakt të humbjes së ujërave të tij në zhavore.

Pjerrësia e rrjedhjes së ujit në lumë gjatë kohës kur nivelet janë të ulëta është mesatarisht 0.7 për mijë dhe për prurje të plotë të lumit pjerrësia është 2.7 për mijë. Shpejtësia e rrjedhjes lëviz nga 0.4 m/sek për nivele të ulëta në 2 m/sek për nivele mesatare dhe 3 m/sek kur nivelet e ujit në lumë janë maksimale. Lumi i Kirit ka një amplitudë vjetore deri 5 m.

Infrastruktura

Karakteristikë e kësaj zone është se infrastruktura është e zhvilluar, pasi është shumë afër zonave urbane të rëndësishme siç është qyteti i Shkodrës. Zhvillimi i projektit nuk ka nevojë për zhvillim të infrasturës shtesë për zhvillimin e tij.

3.4 Tokat, kategoria e tokës dhe gjeologjia

Toka ndërton shtresën sipërfaqësore të fushës ku është vendosur fshati Bardhaj dhe përfaqësohet nga alevrite-argjilore që bëjnë pjesë në tokat e hirta kafe.

Në ndërtimin gjeologjik të rajonit (figura 6), dalin në sipërfaqe shkëmbinj të moshave mesozoike dhe kenozoike dhe përfshihen depozitime të zonave tektonike Krasta-Cukali dhe Mirdita. Meqenëse projekti do të zhvillohet vetëm në depozitimet Kuaternare dhe Jurasikut po përshkruajmë këto depozitime.

Jurasiku i sipërm (J₃)

Depozitimet terigjene të Jurasikut të sipërm përhapen në pjesën veriore dhe perëndimoret të masivit ultrabazik të Bardhanjoreve. Ato përfaqesohen nga melanzhi "bllloqe në matriks" (ose "pakoja argjilite me copa"). Melanzhi "bllloqe në matriks" ka përhapje të kufizuar në zonë. Ai përbëhet nga silicorët radiolaritikë e vullkanitet e pjesës së sipërme të masivëve ofiolitikë jurasikë të ndëthurur nga rreshpe argjilo-silicore ngjyre gri, gri të gjelbër, gri të errët. Kanë marrdhënie tektonike me shkëmbinj të rrethues. Trashësia e depozitimeve brekçore është deri 250 - 300m

Kuaternari (Q)

Depozitimet e Kuaternarit kanë përhapje të gjerë, nga përroi i Vrakës, fusha e Shtojit të Vjetër, në veri deri bregdet, si dhe në luginën e lumit Kir dhe në shpatet e rrafshinat malore, pranë fshatrave Bardhaj, Blerin e Myselim duke përfaqësuar pothuaj të gjitha tipet gjenetike nga ato kontinentale (eluvione, deluvione, koluvione, proluvione, aluvione, akullnajore, kënetore, liqenore), ndërmjetëse (lagunore, deltore) dhe depozitimet detare. Në mjaft raste takohen dhe tipe gjenetike të përziera si aluvialo-proluviale, aluvialo-kënetore, proluvialo-liqenore etj. Në kushtet kur edhe ujëmbajtja kryesore e rajonit është e lidhur me këto depozitime po i japim me një përshkrim më të detajuar e me përhapje edhe më të madhe se rajoni i studimit.

Sipas kohës së formimit këto depozitime janaë:

- Depozitimet e pleistocen-holocenit – Q(p-h).
- Depozitimet e holocenit të hershem – Qh₁.
- Depozitimet e holocenit të vonshem – Qh₂.

Depozitimet e pleistocen-holocenit – Q(p-h).

Në këtë grup kemi përfshirë të gjitha ato depozitime të Kuaternarit të hershëm (Pleistocen-Holocenit) të formuara në fundin e shpateve paramalore dhe në luginat e brendëshe të lumenjëve dhe prrënjeve që përfshin territori i studimit. Këto depozitime përhapen rrëze kondrave dhe fushën pranë tyre në anën lindoret të fshatrave Bardhaj, Blerin e Myselim.

Përfaqësohen nga material i përzier kryesisht copëzore, deluvione, proluvione dhe koluvione i perzier me pak material argjilor. Prania e materialit argjilore është më e madhe në fundin e shpateve paramalore se sa në depozitimet e mbrendëshe të luginave të lumenjeve.

Depozitimet e holocenit të hershëm – Qh₁,

Depozitimet e holocenit të hershëm janë formuar zonën fushore të territorit të studimit, duke patur përhapjen më të madhe të tyre në fushat e Shtojit të Vjetër, Bardhaj, Myselim. Përfaqësohen kryesisht nga depozitime aluviale, argjila dhe rera, nga depozitime proluviale dhe deluviale, zhavore të përziera me rëra

Depozitimet e holocenit të vonshëm – Qh₂

Këto depozitime përfshijnë gjithë depozitime e sotme të kuternarit. Keto depozitime, në zonë e studimit, kanë përhapje në gjithë shtratin e Lumit Kir. Ato përfaqësohen kryesisht nga zhavore kokërrtrasha deri të imët dhe me pak nga rëra dhe llumra.

3.5 Trashegimia arkeologjike dhe historike

Shkodra ka trashëgimi arkeologjike dhe një trashëgimi historike të veçantë. Por në zonën ku do të zhvillohet projekti nuk ka ndonjë trashëgimi historike të vecantë.

3.6 Peisazhi dhe topografia

Vendi i zhvillimi të projektit dhe shfrytëzimi i tij nuk ka peisazhe në menyrë të tillë, që të jenë të mbrojtura. Gjithashtu gjatë zhvillimit të projektit nuk do të ketë ndryshime në peisazhin e zonës.

3.7 Tiparet e tjera mjedisore

